



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA”
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 754
Datë: 7 / 3 / 2024

RREGULLORE

**PËR RREGULLAT DHE PROCEDURAT PËR ZGJEDHJET E PËRGJITHSHME
TË PERSONELIT AKADEMIK DHE JOAKADEMIK NË NIVEL TË
PËRFAQËSIMIT NË UNIVERSITETIN E PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”**

Universiteti i Prishtinës
29.02.2024

Në mbështetje të nenit 23 të Statutit, si dhe në pajtim me Ligjin nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë të Republikës së Kosovës, Këshilli Drejtues i Universitetit të Prishtinës, me datë 29.2.2024, miratoi

RREGULLORE

PËR RREGULLAT DHE PROCEDURAT PËR ZGJEDHJET E PËRGJITHSHME TË PERSONELIT AKADEMIK DHE JOAKADEMIK NË NIVEL TË PËRFAQËSIMIT NË UNIVERSITETIN E PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"

PËRMBAJTJA

Neni 1. Qëllimi dhe fushëveprimi i rregullores	4
Neni 2. Dispozitat e përgjithshme	4
Neni 3. Shkurtesat.....	4
Neni 4. Organet për të cilat mbahen zgjedhjet	4
Neni 5. Personeli që ka të drejtë të marrë pjesë në zgjedhje	5
Neni 6. Mandatet e fituara nga zgjedhjet	5
Neni 7. Kufizimet në të drejtën e zgjedhjes	6
Neni 8. Rregullat, procedurat zgjedhore dhe përbërja e këshillave të fakulteteve	8
Neni 9. Verifikimi i mandateve të anëtarëve të këshillit të fakultetit	9
Neni 10. Zgjedhjet për Senat, personelin akademik dhe joakademik.....	9
Neni 11. Kandidimi për këshillin e fakultetit dhe për Senat	11
Neni 12. Zgjedhja e kryesuesit të përkohshëm të këshillit të fakultetit dhe përfaqësuesit të përkohshëm - dekanit në Senat	11
Neni 13. Nominimi i kandidatëve për pozitën e dekanit dhe procesi i zgjedhjes	12
Neni 14. Listat e votuesve	13
Neni 15. Përmbajtja e listës së votuesve.....	13
Neni 16. Regjistrimi i kandidatëve për Këshill dhe Senat	13
Neni 17. Përmbajtja e listës së kandidatëve	14
Neni 18. Komisioni Qendror Zgjedhor - KQZ UP.....	15
Neni 19. Ankesat	16
Neni 20. Komisioni Zgjedhor i Fakultetit - KZF	16
Neni 21. Komisioni Zgjedhor i Administratës Qendrore - KZAQ	17
Neni 22. Data e zgjedhjeve të përgjithshme.....	17
Neni 23. Mënyra e votimit.....	18
Neni 24. Mbikëqyrja e procesit zgjedhor	18
Neni 25. Procedurat e votimit dhe fletëvotimet.....	18
Neni 26. Rrjedha e procedurës zgjedhore dhe të votimit	18
Neni 27. Fletëvotimi dhe vlefshmëria.....	19
Neni 28. Rezultatet e zgjedhjeve dhe hedhja e shortit.....	19
Neni 29. Periudha e ankesave pas shpalljes së rezultateve	20
Neni 30. Përfundimi i mandateve	20
DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE	20
Neni 31. Vlefshmëria dhe zbatimi.....	20
Neni 32. Shfuqizimi	21
Neni 33. Hyrja në fuqi.....	21
SHTOJCA NR. 1 - FORMULARI PËR APLIKIM.....	22
SHTOJCA NR. 2 - FORMULARI PËR ANKESA	23

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi i rregullores

1. Kjo rregullore ka për qëllim rregullimin e mënyrës së organizimit, kritereve dhe procedurave të zgjedhjeve në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina", si dhe procedurat zgjedhore në kuadër të këtyre zgjedhjeve.
2. Kjo rregullore zbatohet vetëm për zgjedhjet në organet e Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina".

Neni 2

Dispozitat e përgjithshme

1. Të gjitha rregullat dhe procedurat zgjedhore, siç përcaktohen me këtë rregullore, bazohen në Statutin e UP-së, si dhe legjislacionin në fuqi, i cili është relevant përkitazi me çështjet që përcaktohen në këtë rregullore.
2. Secila palë e pakënaqur lidhur me procedurat zgjedhore ka të drejtë ankese kundër vendimeve të nxjerra në kuptim të kësaj rregulloreje. Instancë e parë për shqyrtimin e ankesave janë Komisioni Zgjedhor i Fakultetit (KZF) dhe Komisioni Zgjedhor i Administratës Qendrore (KZAQ).
3. Ankesa kundër vendimit të KZF-së dhe KZAQ-së i parashtrohet Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ UP). Vendimi i KQZ UP-së është përfundimtar.

Neni 3

Shkurtesat

Shkurtesat e përdorura në këtë rregullore kanë kuptimin si në vijim:

- UP – Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina";
- KQZ UP – Komisioni Qendrori Zgjedhjeve të Universitetit të Prishtinës;
- KZF – Komisioni Zgjedhor i Fakultetit;
- KZAQ – Komisioni Zgjedhor i Administratës Qendrore;
- KF – Këshilli i Fakultetit;
- BQU – Biblioteka Qendrore Universitare;
- AQ – Administrata Qendrore;

Neni 4

Organet për të cilat mbahen zgjedhjet

1. Zgjedhjet në UP mbahen duke u bazuar në nenet përkatëse të Statutit të UP-së, të cilat rregullojnë çështjet përkatëse zgjedhore.
2. Zgjedhjet në UP organizohen në të gjitha fakultetet për kategoritë si në vijim:
 - 2.1. Anëtarët e këshillave të fakulteteve nga radhët e profesorëve;
 - 2.2. Anëtarët e këshillave të fakulteteve nga radhët e asistentëve;
 - 2.3. Anëtarin e këshillave të fakulteteve nga radhët e personelit joakademik;
 - 2.4. Anëtarin e Senatit nga radhët e personelit akademik;

- 2.5. Anëtarët e Senatit nga radhët e personelit joakademik;
3. Zgjedhjet për anëtarë të Senatit nga radhët e personelit joakademik do të mbahen edhe në AQ dhe në BQU.
4. Kjo rregullore përcakton edhe procedurën e nominimit dhe zgjedhjes së dekanit të njësive akademike.

Neni 5

Personeli që ka të drejtë të marrë pjesë në zgjedhje

1. Në zgjedhjet të cilat zhvillohen në UP, në kategoritë e përcaktuara në nenin 4 të kësaj rregulloreje, ka të drejtë të kandidojë i gjithë personeli i zgjedhur i UP-së në marrëdhënie të rregullt të punës, sipas kriterëve të përcaktuara në këtë rregullore. Personeli akademik i UP-së, në kuptim të këtij paragrafi, përfshin kategoritë e përcaktuara në Statut si në vijim:
 - 1.1. Profesor i rregullt;
 - 1.2. Profesor i asociuar;
 - 1.3. Profesor asistent;
 - 1.4. Asistent;
 - 1.5. Lektor dhe
 - 1.6. Korepetitor.
2. Personel akademik i UP-së, në kuptim të Statutit, konsiderohen të gjithë ata/ato të cilët kanë fituar thirrjen përkatëse akademike, duke pasur parasysh ditën e nxjerrjes së vendimit përfundimtar nga Senati i UP-së.
3. Përrjashtim nga paragrafi 2 i këtij neni bëhet për personelin e zgjedhur për herë të parë në UP dhe që nuk mund të pajiset me kontratë të rregullt pune deri në datë të caktuar (data e fillimit të semestrit dimëror ose semestrit veror). Kjo kategori e personelit ka të drejtë të kandidojë vetëm në rast se pajiset me kontratë të rregullt, në datë të caktuar (data e fillimit të semestrit dimëror ose veror).
4. Kriteret e njëjta të parapara në paragrafin 3 të këtij neni zbatohen edhe ndaj personelit joakademik, i cili deri në momentin e regjistrimit për pjesëmarrje në zgjedhje nuk është i pajisur me kontratë për themelimin e marrëdhënies së rregullt të punës në UP.

Neni 6

Mandatet e fituara nga zgjedhjet

1. Të gjithë ata të cilët fitojnë mandat dhe përfaqësohen në organet përkatëse brenda UP-së, nga zgjedhjet e mbajtura sipas kësaj rregulloreje, e ushtrojnë mandatin e tyre bazuar në Statutin e UP-së dhe këtë rregullore.
2. Në rast të dorëheqjes, ndërprerjes së marrëdhënies së punës/humbjes së statusit të personelit akademik, pensionimit, vdekjes, marrjes së mandatit apo humbjes së mandatit, para përfundimit të tij për shkak të ndonjë arsyeje tjetër, mandati do t'i takojë personit të parë në listën e pritjes sipas regjistrimit të rezultatit të zgjedhjeve. Ky paragraf vlen vetëm për anëtarët e këshillave të fakulteteve. Në rast se nuk ka personel akademik në listën e

pritjes, për shkak se në rastin e mbajtjes së zgjedhjeve, numri i personelit akademik nuk është plotësuar (30 profesorë, respektivisht 8 asistentë) dhe ndërkohë numri i personelit akademik pas mbajtjes së zgjedhjeve është shtuar (jo më pak se 5 personel i ri akademik, profesor ose asistent), mbahen zgjedhjet për KF, vetëm për pjesën e personelit akademik, i cili është zgjedhur/emëruar pas mbajtjes së zgjedhjeve, me kusht që koha e ushtrimit të mandatit të tyre të jetë së paku dy (2) vite, brenda mandatit katër (4) vjeçar.

3. Një anëtar i personelit akademik, i cili në zgjedhjet e mbajtura për anëtarë të këshillit të fakultetit është zgjedhur apo është në listën e pritjes, me rastin e zgjedhjes apo emërimit në pozitën e anëtarit të Këshillit Drejtues, rektorit, prorektorit apo anëtarit/es së Senatit, në mënyrë automatike e humb të drejtën për ta ruajtur mandatin e anëtarit të KF-së, pavarësisht nëse mandati nga njëra prej pozitave si më sipër përfundon para kohe.
4. Plotësimi i mandatit të mbetur vakant, si rezultat i përmbushjes së njëres prej arsyeve të cekura si në paragrafin e sipërhënuar, duhet të plotësohet më së largu 48 orë pune pas mbetjes vakante të pozitës.
5. Në rastet kur nuk ka persona në dispozicion nga rezultatet e zgjedhjeve si në paragrafin 2 të këtij neni, fakulteti përkatës, respektivisht Administrata Qendrore dhe Biblioteka Qendrore Universitare, do t'i mbajnë zgjedhjet për plotësimin e mandateve vakante sipas procedurave të njëjta të përcaktuara në këtë rregullore, më së largu dhjetë (10) ditë pas mbetjes vakante të pozitës. Zgjedhjet në këtë rast administrohen nga KZF, KZAQ dhe KQZ UP.

Neni 7

Kufizimet në të drejtën e zgjedhjes

1. Personeli akademik dhe joakademik në marrëdhënie të rregullt pune, i cili është i zgjedhur apo emëruar në ndonjë institucion tjetër publik, apo me vendim të organeve të UP-së i ka të pezulluara të drejtat dhe detyrimet, ose që arrin moshën e pensionimit në vitin kur mbahen zgjedhjet, nuk ka të drejtë për t'u zgjedhur në organet drejtuese, por ka të drejtë për të votuar për kategoritë e përcaktuara në këtë rregullore.
2. Personeli akademik i zgjedhur apo emëruar në një funksion tjetër publik, në kuptim të paragrafit 1 të këtij neni, nënkupton zgjedhjen apo emërimin si në vijim: President i Republikës së Kosovës; deputet në Kuvendin e Kosovës; anëtar i Qeverisë së Republikës së Kosovës; anëtar i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës; funksionarët e emëruar nga Kuvendi, Presidenti i Republikës dhe titullarët apo anëtarët e organeve drejtuese kolegjiale të institucioneve të pavarura dhe të agjencive të pavarura; funksionarët e emëruar nga Presidenti; anëtarët e Këshillit Gjyqësor dhe Prokurorial të Kosovës, këshilltar politik apo funksionet e tjera në sistemin e drejtësisë; sekretarët e përgjithshëm në ministri; kryeshefat e agjencive të pavarura.
3. Përrjashtim nga kategoria e përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni bëjnë i gjithë personeli akademik, të cilët ofrojnë këshilla për institucione publike, si këshilltarë, konsulentë apo janë anëtarë të komisioneve profesionale dhe grupeve të ndryshme të ekspertëve, anëtarët e Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KSHC), për shkak të kriterëve ligjore të zgjedhjes së tyre, si dhe personeli akademik i Fakultetit të Mjekësisë, i punësuar në nivelin terciar shëndetësor (QKUK, QSKUK, IKSHPK).

4. Nuk kanë të drejtë të zgjidhen në pozitat: rektor, prorektor, anëtar/e e Senatit, anëtar/e e këshillit të fakultetit, dekan dhe prodekan, të gjithë ata/ato që janë të dënuar për kryerjen e veprës penale me vendim gjyqësor të formës së prerë dhe që kanë të shqiptuar masë disiplinore nga organet kompetente të universitetit, në tre (3) vjetët e fundit, përfshirë masat e shqiptuara nga Këshilli i Etikës për personelin akademik. Nuk kanë të drejtë të zgjedhen në pozitat rektor, prorektor, dekan dhe prodekan, të gjithë ata/ato të cilëve i është shqiptuar masa e shkarkimit nga pozita që kanë ushtruar, në tre (3) vitet e fundit.
5. Personeli akademik dhe joakademik i fakultetit mund të kandidojë për t'u zgjedhur, por nuk mund të ushtrojë njëkohësisht mandatin e anëtarit të këshillit të fakultetit dhe të anëtarit të Senatit. Anëtari i këshillit të fakultetit nga radhët e personelit akademik dhe joakademik që zgjidhet anëtar i Senatit duhet të heqë dorë nga anëtarësia në këshillin e fakultetit në momentin e zgjedhjes.
6. Anëtarët e Senatit të UP-së nuk kanë të drejtë të zgjidhen për më shumë se dy (2) mandate. Në kuadër të llogaritjes së dy (2) mandateve nuk hyn anëtarësia sipas detyrës zyrtare si dekan.
7. Me qëllim të shmangies së konfliktit eventual të interesit, të drejtë për t'u zgjedhur në organet drejtuese të UP-së, sipas këtij neni, nuk kanë të gjithë ata që përfaqësojnë dhe mbrojnë UP-në në organet administrative dhe gjyqësore, në të cilat organe vendimet e UP-së mund të kontestohen nga palët e pakënaqura.
7. Organe drejtuese në kuptim të paragrafit 1 të këtij neni përfshijnë përfaqësimin në organet si në vijim: Këshill të fakultetit; prodekan; dekan; prorektor; rektor; anëtar/e i Senatit dhe Këshill Drejtues.
8. Për pozitat rektor dhe prorektor nuk mund të zgjidhen anëtarët e Këshillit Drejtues të UP-së, pa kaluar afati prej dy (2) viteve nga momenti i përfundimit të mandatit të anëtarit të Këshillit Drejtues të UP, për shkak të parandalimit të konfliktit të interesit. Anëtarët e Këshillit Drejtues kanë të drejtë të zgjedhen anëtar/e të Senatit, dekan, prodekan dhe anëtarë të Këshillit të Fakultetit, me kusht që të japin dorëheqje paraprakisht nga pozita.
9. Për pozitat dekan, anëtar i Senatit, rektor, nuk mund të zgjidhen kandidatët të cilët pengohen që ta ushtrojnë së paku gjysmën e mandatit të plotë, për shkak të plotësimit të moshës mandatore të pensionit. Gjysma e mandatit llogaritet nga data e fillimit të mandatit, më 1 tetor të vitit përkatës kur e fillon mandatin.
10. Në rastet e kontestueshme, në lidhje me të drejtën për të votuar ose të drejtën për kandidim, vendimi i shkallës së parë merret nga KZF dhe KZAQ, me rastin e verifikimit të kandidaturave, kurse vendimi i shkallës së parë mund të ankimohet në KQZ UP.
11. Lidhur me ankesën e ushtruar sipas kësaj rregulloreje, KQZ UP nxjerr vendim përfundimtar në procedurë administrative dhe duhet ta arsyetojë siç parashihet me dispozitat përkatëse të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Vendimi i KQZ UP-së është përfundimtar.

Neni 8

Rregullat, procedurat zgjedhore dhe përbërja e këshillave të fakulteteve

1. Çdo fakultet ka këshillin. Anëtarët e këshillit janë:
 - 1.1. Dekani;
 - 1.2. Prodekanët;
 - 1.3. Sekretari i fakultetit, pa të drejtë vote;
 - 1.4. Deri në tridhjetë (30) anëtarë të zgjedhur nga radhët e profesorëve të fakultetit;
 - 1.5. Deri në tetë (8) anëtarë të zgjedhur nga radha e asistentëve të fakultetit;
 - 1.6. Një (1) anëtar i zgjedhur nga personeli joakademik i fakultetit;
 - 1.7. Dy (2) përfaqësues të studentëve të zgjedhur nga këshilli i studentëve të fakultetit.
2. Anëtarë të këshillit të fakultetit zgjidhen deri tridhjetë (30) profesorë, të cilët kanë thirrjen akademike profesor i rregullt, profesor i asociuar, profesor asistent, me kusht që thirrjen akademike ta kenë fituar nga Senati i UP-së, para shpalljes së zgjedhjeve në UP sipas kësaj rregulloreje.
3. Në fakultetet, ku numri i përgjithshëm i profesorëve që kandidojnë, siç përcaktohet në paragrafin 2 të këtij neni, nuk e kalon numrin tridhjetë (30), të gjithë profesorët të cilët regjistrohen për të fituar mandatin në këshillin e fakultetit, mandatohen automatikisht si anëtarë të këshillit të fakultetit. Në raste të tilla, mandatet e mbetura të lira nuk mund të plotësohen me anëtarë të rinj të personelit akademik, sipas këtij paragrafi, për shkak të mungesës në listën e pritjes por në këtë rast aplikohet përjashtimi sipas nenit 6.2, në rast se plotësohen kushtet.
4. Anëtarët e këshillit të fakultetit nga radhët e profesorëve dhe të asistentëve zgjidhen nga personeli akademik i fakultetit (profesorë dhe asistentë), siç përcaktohet në këtë rregullore.
5. Numri i asistentëve të zgjedhur në Këshillin e Fakultetit është më së shumti 8 (tetë) anëtarë.
6. Në fakultetet ku numri i përgjithshëm i asistentëve që kandidojnë, siç përcaktohet në paragrafin 5 të këtij neni, nuk e kalon numrin 8 (tetë), të gjithë asistentët që regjistrohen për të fituar mandatin si anëtarë të këshillit të fakultetit, mandatohen automatikisht anëtarë të këtij këshilli. Në raste të tilla mandatet e mbetura të lira nuk mund të plotësohen me anëtarë të rinj të personelit akademik sipas këtij paragrafi.
7. Në rast se anëtari i këshillit të fakultetit e ka fituar mandatin e tij/saj si asistent dhe ndërkohë është avancuar, respektivisht është zgjedhur në pozitën e profesorit asistent, i/e njëjti/a vazhdon të mbajë mandatin e tij/saj mbi bazën, me të cilën e ka fituar.
8. Pavarësisht dispozitave të tjera të kësaj rregulloreje, anëtari i zgjedhur i këshillit të fakultetit, i cili fiton mandatin si anëtar i këtij organi dhe ndërkohë zgjidhet dekan ose prodekan i fakultetit përkatës, mandati i tij/saj nuk zëvendësohet, sipas listës së pritjes. Ky kufizim nuk vlen në rast të zgjedhjes të tij/saj si rektor, prorektor ose anëtar i Këshillit Drejtues. Nëse mandati i anëtarit të këshillit nuk fitohet me zgjedhje, por përmes emërimit si dekan ose prodekan, atëherë me rastin e humbjes së mandatit si dekan ose prodekan, humbet edhe mandati i tij/saj si anëtar/e i këshillit të fakultetit.

9. Për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit të fakultetit nga radhët e profesorëve (profesor i rregullt, profesor i asociuar dhe profesor asistent) dhe asistentëve, të drejtë vote kanë të gjithë profesorët dhe asistentët që janë në marrëdhënie të rregullt pune në fakultet, sipas kësaj rregulloreje.
10. Për zgjedhjen e anëtarit të këshillit të fakultetit nga radhët e personelit joakademik, të drejtë vote ka i tërë personeli joakademik në marrëdhënie të rregullt pune në fakultet.
11. Dy (2) përfaqësues nga radha e studentëve në këshillin e fakultetit zgjidhen sipas propozimit të Këshillit të Studentëve të fakultetit, në pajtim me dispozitat e Rregullores mbi zgjedhjet e studentëve dhe punën e Parlamentit Studentor dhe këshillave të studentëve.
12. Sekretari i fakultetit është anëtar i këshillit të fakultetit, sipas detyrës zyrtare, pa të drejtë vote dhe është përgjegjës për ligjshmërinë e punës së këshillit të fakultetit.

Neni 9

Verifikimi i mandateve të anëtarëve të këshillit të fakultetit

1. Këshilli i fakultetit, në mbledhjen e parë të tij, bën verifikimin e mandateve të anëtarëve, në bazë të raportit të sekretarit të fakultetit, për rregullsinë e zgjedhjes së anëtarëve të këshillit të fakultetit, me propozim për miratimin e mandatit.
2. Votimi për raportin sipas paragrafit 1 të këtij neni bëhet në tërësi nëse nuk është kontestuar asnjë mandat. Në rast se ndonjë mandat kontestohet, së pari votohet për të gjitha mandatet e pakontestueshme, e pastaj ndaras votohet për çdo mandat që kontestohet.
3. Kandidatit për anëtar të këshillit të fakultetit, që i është kontestuar mandati ose i është shtyrë vendimi për verifikimin e mandatit, ka të drejtë të vazhdojë pjesëmarrjen në mbledhjet e këshillit të fakultetit, por pa të drejtë vote.
4. Pas verifikimit të mandatit, anëtarët e këshillit të fakultetit e nënshkruajnë deklaratën etike si vijon: "*Deklaroj se do t'i kryej detyrat me nder dhe me besnikëri, me drejtësi dhe pa anim, me ndërgjegje dhe përgjegjësi, se do t'i përfaqësoj me ndërgjegje dhe përkushtim interesat e fakultetit dhe të universitetit në përgjithësi, si dhe do t'i përmbahem statutit të universitetit dhe legjislacionit të aplikueshëm në Republikën e Kosovës*".
5. Në rast të pakënaqësisë përkitazi me verifikimin e mandateve për anëtarët e këshillit të fakultetit, kandidati/ja që i kontestohet mandati ka të drejtë ankese në KQZ UP, sipas dispozitave të kësaj rregulloreje.

Neni 10

Zgjedhjet për Senat, personelin akademik dhe joakademik

1. Një anëtar i personelit akademik nga secili fakultet zgjidhet anëtar i Senatit.

2. Përfaqësuesi i fakultetit në Senat do të zgjidhet nga personeli akademik i secilit fakultet siç përcaktohet në statut, respektivisht profesor i rregullt, profesor i asociuar, profesor asistent dhe asistent.
3. Përfaqësuesi i fakultetit në Senatin e UP-së zgjidhet me shumicën absolute (50%+1) të votave të të gjithë personelit akademik që marrin pjesë në votim.
4. Për zgjedhjen e përfaqësuesit të fakultetit në Senat, të drejtë vote ka i tërë personeli akademik në marrëdhënie të rregullt pune në fakultet, në pajtim me dispozitat e kësaj rregulloreje.
5. Dy përfaqësuesit e stafit joakademik në Senat zgjidhen me shumicën absolute të votave (50% +1) të të gjithë atyre që marrin pjesë në votim, nga radhët e personelit joakademik në marrëdhënie të rregullt pune në të gjitha fakultetet, në Bibliotekën Qendrore Universitare dhe në Administratën Qendrore të UP-së.
6. Për zgjedhjen e përfaqësuesve të stafit joakademik në Senat, të drejtë vote ka i gjithë personeli joakademik në marrëdhënie të rregullt pune në UP.
7. Nëse asnjë nga kandidatët për Senat nga personeli akademik dhe joakademik nuk e marrin shumicën absolute të votave të personelit akademik, respektivisht joakademik që marrin pjesë në votim, atëherë organizohet raundi i dytë i votimit për dy kandidatët për personelin akademik, respektivisht katër kandidatë për personelin joakademik, të cilët kanë më së shumti vota në raundin e parë. Konsiderohet i zgjedhur kandidati/ja që fiton shumicën e votave në raundin e dytë, përkatësisht dy (2) kandidatët që fitojnë më së shumti vota në këtë raund nga radhët e personelit joakademik.
8. Raundi i dytë për zgjedhjen e anëtarëve të Senatit nga personeli akademik dhe joakademik mbahet më së largu dy (2) ditë pune nga dita e përfundimit të raundit të parë.
9. Në rast se ka dy ose më shumë kandidatë me vota të barabarta në raundin e dytë, përzgjedhja e kandidatëve bëhet në praninë e kandidatëve, përmes hedhjes së shortit. Shorti hidhet nga KQZ UP.
10. Votimi për anëtar të Senatit nga personeli akademik dhe joakademik bëhet në atë mënyrë që të gjithë kandidatët renditen në fletëvotim, në bazë të alfabetit. Të gjithë ata/ato që marrin pjesë në votim kanë të drejtë të votojnë vetëm një kandidat për anëtar të Senatit nga radhët e personelit akademik, respektivisht dy kandidatë nga radhët e personelit joakademik.
11. Sekretari i përgjithshëm i universitetit është anëtar, sipas detyrës zyrtare (ex officio), i Senatit, pa të drejtë vote dhe është përgjegjës për ligjshmërinë e punës së Senatit.
12. Në rast të dorëheqjes, ndërprerjes së marrëdhënies së punës, pensionimit, vdekjes, apo në çfarëdo rasti të mbetjes vakante të mandatit të përfaqësuesit të fakultetit në Senat nga radhët e personelit akademik apo joakademik, fakulteti përkatës, përkatësisht fakultetet, Biblioteka Qendrore Universitare dhe Administrata Qendrore e UP-së (në rastin e përfaqësuesit në Senat të personelit joakademik) mbajnë zgjedhjet për zgjedhjen e anëtarit të ri të Senatit, sipas procedurave të njëjta të përcaktuara në këtë rregullore, më

së largu dhjetë (10) ditë pas mbetjes vakante të pozitës. Zgjedhjet administrohen nga KZF, KZAQ dhe KQZ UP.

13. Anëtarët e Senatit nga radhët e personelit akademik dhe joakademik nuk mandatohen me automatizëm edhe në rastin kur numri i kandidatëve është i barabartë me numrin e mandateve. Në secilin rast, kandidati konsiderohet i zgjedhur sipas përcaktimeve të dispozitave të këtij neni dhe procedurës së zhvilluar.
14. Përfaqësuesi i fakultetit në Senatin e UP-së ka të drejtë pjesëmarrjeje në mbledhjet e këshillit të fakultetit, por pa të drejtë vote.

Neni 11

Kandidimi për këshillin e fakultetit dhe për Senat

1. Anëtari i personelit akademik dhe joakademik i UP-së ka të drejtë të regjistrohet si kandidat për mandatin e caktuar sipas dispozitave të kësaj rregulloreje dhe Statutit.
2. Anëtarët e KQZ UP-së dhe KZF-së mund të kandidojnë në zgjedhjet e përgjithshme të UP-së, vetëm në nivel të këshillit të fakultetit, por jo edhe në pozita menaxhuese dhe qeverisëse të universitetit (dekan, senator apo rektor), pa dhënë dorëheqjen paraprakisht.
3. Anëtarët e KZAQ-së mund të zgjedhin, por nuk mund të kandidojnë në zgjedhjet e personelit joakademik në nivel të përfaqësimit në Senatin e UP-së, pa dhënë dorëheqjen paraprakisht.
4. Anëtarët e dorëhequr për arsyet si në paragrafët 2 dhe 3 zëvendësohen pa vonesë dhe sipas procedurës së njëjtë si të emërimit.
5. Të gjithë kandidatët e interesuar kanë të drejtë të regjistrohen për të fituar më shumë se një mandat, sipas kësaj rregulloreje.
6. Në qoftë se një anëtar i personelit zgjidhet në më shumë se një organ në UP, kandidati, pas zgjedhjes, përcaktohet se në cilin organ do ta ushtrojë mandatin e tij/saj, në pajtim me dispozitat e kësaj rregulloreje.

Neni 12

Zgjedhja e kryesuesit të përkohshëm të këshillit të fakultetit dhe përfaqësuesit të përkohshëm - dekan në Senat

1. Kryesuesi i përkohshëm i këshillit të fakultetit zgjidhet nga kandidatët e propozuar anëtarëve të këshillit të fakultetit, me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të këshillit të fakultetit, në mbledhjen e parë të verifikimit të mandateve të anëtarëve të këshillit të fakultetit.
2. Nëse asnjë nga kandidatët e propozuar për kryesues të përkohshëm të KF-së nuk e merr shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve, atëherë organizohet rasti i dytë i votimit, vetëm për kandidatin me numër më të madh të votave. Nëse kandidati nuk merr shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve, në radhën e dytë,

konsiderohet se kandidati është refuzuar dhe KF-ja është i obliguar të propozojë kandidat tjetër.

3. Votimi bëhet në atë mënyrë që të gjithë kandidatët vendosen në një fletëvotim sipas alfabetit dhe të gjithë ata që marrin pjesë në votim kanë të drejtë të votojnë vetëm për një kandidat.
4. Në rast të votave të barabarta mes kandidatëve të propozuar, votimi përsëritet.
5. Kryesuesi i përkohshëm i KF-së është edhe përfaqësues i dekanit të fakultetit në Senat deri në zgjedhjen e dekanit.

Neni 13

Nominimi i kandidatëve për pozitën e Dekanit dhe procesi i zgjedhjes

1. Çdo anëtar i këshillit të fakultetit ka të drejtë të propozojë një kandidat/e për pozitën e dekanit, kjo mund të bëhet verbalisht ose me shkrim. Propozimi i kandidatit/es për pozitën e dekanit bëhet në fillim të mbledhjes së thirrur për zgjedhjen e dekanit.
2. Propozimet për kandidatët për dekan duhet të jenë të arsyetuara dhe të përfshijnë edhe një biografi të shkurtë të kandidatit/es.
3. Të gjithë kandidatët e propozuar për dekan përfshihen në fletëvotim dhe radhiten sipas alfabetit me emër dhe mbiemër.
4. Anëtari/ja i/e këshillit të fakultetit ka të drejtë të votojë në fletëvotim vetëm një (1) kandidat për pozitën e dekanit, përmes votimit të fshehtë. Kandidati, i cili merr shumicën absolute të votave të të gjithë anëtarëve të këshillit, konsiderohet i zgjedhur në këtë pozitë dhe i propozohet Senatit për miratim.
5. Nëse asnjë kandidat nuk e arrin shumicën absolute të votave të të gjithë anëtarëve të këshillit të fakultetit në raundin e parë, mbahet raundi i dytë. Edhe në raundin e dytë kandidati/ja, i cili merr shumicën absolute të votave të të gjithë anëtarëve të këshillit, konsiderohet i zgjedhur në këtë pozitë dhe i propozohet Senatit për miratim.
6. Nëse asnjëri prej kandidatëve nuk arrin shumicën absolute të votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të këshillit të fakultetit në raundin e parë dhe të dytë, dy (2) kandidatët më të votuar kalojnë në raundin e tretë. Në raundin e tretë, kandidati/ja për dekan që fiton shumicën absolute konsiderohet i zgjedhur në këtë pozitë dhe i propozohet Senatit për miratim.
7. Në rast të votave të barabarta në raundin e tretë, atëherë procedura përsëritet nga fillimi. Votimi i radhës duhet të mbahet jo më vonë se 24 orë nga dita e mbledhjes kur është bërë votimi i parë.
8. Në rast se për zgjedhje në pozitën e dekanit nuk ka më shumë se një kandidat, procedura për zgjedhjen e dekanit zhvillohet në të tre (3) raundet, nëse ai/ajo nuk e merr shumicën e nevojshme në raundin e parë dhe të dytë.

9. Procedura e votimit për zgjedhjen e dekanit zhvillohet pa ndërprerje dhe brenda të njëjtës ditë dhe të njëjtës mbledhje të këshillit të fakultetit, në kuadër të së cilës është caktuar si pikë e rendit të ditës..
10. Dekani i njësisë akademike zgjidhet për periudhë katër (4) vjeçare, me të drejtë të rizgjedhjes vetëm edhe për një (1) mandat, sipas dispozitave të Statutit.

Neni 14

Listat e votuesve

1. Zyrat administrative të fakulteteve, Biblioteka Qendrore Universitare dhe Administrata Qendrore e UP-së kanë për detyrë t'i ofrojnë KQZ UP-së të dhënat e kompletuara të personelit me të drejtë vote, duke pasur parasysh kufizimet në këtë rregullore.
2. Në rast të vonesës ose refuzimit për të dorëzuar të dhënat nga ndonjë fakultet, Biblioteka Qendrore Universitare apo Administrata Qendrore e UP-së, ndaj personave përgjegjës, do të iniciojë procedura disiplinore nga ana e Këshillit Drejtues të UP-së, pas njoftimit nga ana e KQZ UP-së.

Neni 15

Përmbajtja e listës së votuesve

1. Lista e personelit akademik dhe joakademik me të drejtë vote për fakultet do të përgatitet nga komisioni zgjedhor i fakultetit përkatës.
2. Listat e personelit të Administratës Qendrore dhe të Bibliotekës Qendrore Universitare me të drejtë vote do të përgatiten nga KZAQ-ja.
3. Listat e personelit me të drejtë vote do të përfshijnë të dhënat në vijim:
 - 3.1. Për personelin akademik:
 - 3.1.1. Numri rendor;
 - 3.1.2. Emri dhe mbiemri;
 - 3.1.3. Data, muaji dhe viti i lindjes;
 - 3.1.4. Thirrja akademike;
 - 3.1.5. Fakulteti.
 - 3.2. Për personelin joakademik:
 - 3.2.1. Numri rendor;
 - 3.2.2. Emri dhe mbiemri;
 - 3.2.3. Data, muaji dhe viti i lindjes;
 - 3.2.4. Pozita;
 - 3.2.5. Fakulteti /Administrata Qendrore.

Neni 16

Regjistrimi i kandidatëve për këshill dhe Senat

1. Çdo anëtar i personelit akademik apo joakademik ka të drejtë të kandidohet për anëtar të këshillit të fakultetit dhe anëtar të Senatit, përveç kufizimeve të përcaktuara në këtë rregullore dhe kufizimet tjera të përcaktuara me Statut.

2. Procedurat e regjistrimit përgatiten për secilin fakultet.
3. Regjistrimi i kandidatëve bëhet në ditën e përcaktuar nga KQZ UP-ja, sipas dinamikës zgjedhore.
4. Dita e regjistrimit duhet të jetë së paku tre (3) ditë para ditës së zgjedhjeve.
5. Personeli akademik dhe joakademik, regjistrimin e kandidaturës, duhet ta bëjë në formën elektronike, sipas aplikacionit të përgatitur nga KQZ UP. Aplikacionet dhe listat e kandidatëve, të miratuara nga KZF dhe KZ AQ, i dërgohen KQZ UP-së, jo më larg se një (1) ditë, pas mbylljes së afatit të regjistrimit.
6. Një formular përkatës për regjistrim, sipas shtojcës 1 të kësaj rregulloreje, do të jetë në dispozicion në dekanat dhe në ueb faqen zyrtare të UP-së. Pas plotësimit, formulari dorëzohet në e-mailin e sekretarit të fakultetit përkatës, respektivisht kryesuesit të KZAQ-së (për personelin e AQ dhe BQU).

Neni 17

Përmbajtja e listës së kandidatëve

1. Lista e kandidatëve të fakultetit për anëtarë të këshillit të fakultetit, dekan dhe anëtarë të Senatit do të përgatitet nga komisioni zgjedhor i fakultetit përkatës.
2. KQZ UP është i obliguar të kontrollojë çdo regjistrim të kandidaturës sa i përket vlefshmërisë, duke iu referuar listës së votuesve dhe dispozitave të këtyre rregullave dhe procedurave të përcaktuara në këtë rregullore.
3. Lista e kandidaturave të Administratës Qendrore për Senat do të përgatitet nga KZAQ-ja.
4. Listat zyrtare të kandidatëve do të verifikohen dhe miratohen nga Komisioni Qendror Zgjedhor për secilin fakultet dhe administratën qendrore, duke përfshirë të dhënat në vijim:
 - 4.1. Për personelin akademik:
 - 4.1.1. Numri rendor;
 - 4.1.2. Emrin dhe mbiemrin;
 - 4.1.3. Data, muaji dhe viti i lindjes;
 - 4.1.4. Numri personal;
 - 4.1.5. Thirrja akademike;
 - 4.1.6. Fakulteti.
 - 4.2. Për personelin joakademik:
 - 4.2.1. Numri rendor
 - 4.2.2. Emri dhe mbiemri;
 - 4.2.3. Data, muaji dhe viti i lindjes;
 - 4.2.4. Numri personal;
 - 4.2.5. Pozita;
 - 4.2.6. Fakulteti/ Administrata Qendrore.
5. Lista zyrtare e personelit që kandidon, së paku një (1) ditë para zgjedhjeve, do të publikohet nga KQZ UP në ueb faqen e UP-së.

Neni 18 Komisioni Qendror Zgjedhor - KQZ UP

1. Komisioni Qendror Zgjedhor do të përmbushë obligimet e veta, sipas Ligjit Nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë, Statutit të Universitetit të Prishtinës dhe rregulloreve në fuqi.
2. Komisioni Qendror Zgjedhor emërohet nga Këshilli Drejtues, me rastin e shpalljes së zgjedhjeve të përgjithshme, për personel akademik dhe joakademik. KQZ UP është përgjegjës për organizimin dhe mbikëqyrjen e zgjedhjeve të përgjithshme të UP-së, përfshirë edhe zgjedhjet studentore.
3. KQZ UP përbëhet nga dy (2) profesorë në marrëdhënie të rregullt pune në UP dhe sekretari i përgjithshëm i UP-së. Kryesuesi i KQZ-së duhet të jetë nga fusha e drejtësisë, anëtari tjetër nga radhët e profesorëve, i cili me automatizëm është zëvendëskryesues, kurse sekretari i përgjithshëm i UP-së është sekretar i KQZ UP-së. Në cilësinë e vëzhguesit, pjesë e KQZ UP-së është edhe një person nga KQZ UP e Republikës së Kosovës. Për zgjedhjet studentore, nga një përfaqësues prej të gjitha organizatave të studentëve, të cilat janë të certifikuara për zgjedhje, në cilësinë e vëzhguesit, pa të drejtë vote.
4. KQZ UP zgjidhet me rastin e shpalljes së zgjedhjeve të përgjithshme dhe ka mandat katër (4) vjeçar të funksionimit.
5. Përgjegjësitë e KQZ UP-së janë:
 - 5.1. Përcaktimi dhe zbatimi i dinamikës së zgjedhjeve;
 - 5.2. Përgatitja e listave për zgjedhje;
 - 5.3. Nxjerrja e vendimeve rreth kundërshtimeve kundër listës së zgjedhjeve;
 - 5.4. Certifikimi i kandidaturave në zgjedhje;
 - 5.5. Konstatimi i numrit të përgjithshëm të mandateve;
 - 5.6. Vlerësimi i listës së kandidatëve;
 - 5.7. Kryesimi i procedurave zgjedhore;
 - 5.8. Identifikimi i listave përfundimtare të atyre që kanë të drejtë vote;
 - 5.9. Konstatimi i rezultateve të zgjedhjeve;
 - 5.10. Shpallja e rezultateve të zgjedhjeve;
 - 5.11. Certifikimi i mandateve;
 - 5.12. Zëvendësimi i mandatit;
 - 5.13. Koordinimi i komisioneve zgjedhore të Fakulteteve për konstituimin e këshillave të fakulteteve;
 - 5.14. Administrimi i zgjedhjeve në nivel të UP-së;
 - 5.15. Nxjerrja e vendimeve lidhur me mbarëvajtjen e zgjedhjeve në të gjitha nivelet e UP-së;
 - 5.16. Anulimi i procesit zgjedhor në rast të vërtetimit për parregullsi, sipas provave të dorëzuara;
 - 5.17. Administrimi i konstituimit të KF-së, Senatit, organeve tjera, sipas dinamikës zgjedhore;
 - 5.18. Administrimi i periudhës paszgjedhore, përfshirë edhe zëvendësimin e mandateve, pas themelimit të organeve;

- 5.19. Administrimin e procesit zgjedhor, në rast të zgjedhjeve, pas themelimit të organeve, sipas kësaj rregulloreje;
 - 5.20. Kryerjen e detyrave të tjera, sipas kësaj rregullore, ndërlidhur me procesin zgjedhor, sipas kësaj rregulloreje;
 - 5.21. Kryerjen e detyrave tjera që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor, bazuar në dinamikën zgjedhore të miratuar
6. Për të gjitha rastet kur mandati në organet e UP-së për personat e zgjedhur sipas kësaj rregulloreje përfundon para kohe, përbërja e njëjtë e KQZ-UP-së, KZF-së dhe KZAQ-së janë kompetente për zbatimin e procedurave përkitazi me zëvendësimin e mandatit respektiv.

Neni 19 Ankesat

1. Anëtari i personelit ka të drejtë të ankohet kundër vendimeve të KZF-së dhe KZAQ-së, sipas procedurave të përcaktuara në këtë rregullore.
2. Vendimi lidhur me ankesën sipas paragrafit 1 të këtij neni duhet të merret brenda dy (2) ditëve të punës pas pranimit të ankesës. Vendimi në shkallën e dytë nxirret nga KQZ UP dhe është përfundimtar në procedurë administrative.
3. Anëtari i personelit me të drejtë vote për zgjedhjen e organeve përkatëse ka të drejtë të parashtojë ankesë te KQZ UP, në lidhje me procedurat e zgjedhjeve.
4. Formulari përkatës, Shtojca nr. 2, do të jetë në dispozicion në secilin vendvotim në fakultete, vendvotimin për AQ dhe në ueb faqen e UP-së.
5. Në rastet kur KQZ UP, pas shqyrtimit të ankesës, konstaton se ka pasur shkelje dhe mosrespektim të dispozitave të kësaj rregulloreje, mund të rekomandojë anulim të rezultateve dhe përsëritje të procesit zgjedhor. Vendimi përfundimtar merret nga Këshilli Drejtues.

Neni 20 Komisioni Zgjedhor i Fakultetit - KZF

1. Komisioni Zgjedhor i Fakultetit përbëhet nga tre anëtarë:
 - 1.1. Sekretari i fakultetit, kryesues i komisionit zgjedhor ex officio;
 - 1.2. Dy (2) anëtarë nga personeli akademik i fakultetit, nga të cilët të paktën një (1) profesor, të nominuar nga këshilli i fakultetit;
 - 1.3. Për zgjedhjet studentore, nga një përfaqësues prej të gjitha organizatave të studentëve, të cilat janë të certifikuar për zgjedhje, në cilësinë e vëzhguesit pa të drejtë vote.
2. Zgjedhja e anëtarëve të KZF-së bëhet me shumicë të votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të këshillit të fakultetit, përmes votimit të hapur.
3. Procesverbalet e komisionit të zgjedhjeve hartohen dhe nënshkruhen nga kryesuesi dhe anëtarët e KZF-së.

4. Mbledhjet e komisionit zgjedhor të fakultetit thirren nga kryesuesi i KZF-së dhe mund të mbahen në mënyrë fizike dhe përmes platformave online.
5. KZF-ja është përgjegjëse për të zbatuar dinamikën zgjedhore të miratuar nga KQZ UP, në nivel të veprimeve zgjedhor në njësinë akademike.
6. KZF-të zgjidhen me rastin e shpalljes së zgjedhjeve të përgjithshme dhe kanë mandat katër (4) vjeçar të funksionimit.

Neni 21

Komisioni Zgjedhor i Administratës Qendrore - KZAQ

1. Komisioni Zgjedhor i Administratës Qendrore përbëhet nga tre anëtarë:
 - 1.1. Një drejtor të zyrave në AQ-së;
 - 1.2. Një përfaqësues nga BQU-së;
 - 1.3. Një përfaqësues nga zyra ligjore ose në mungesë të tij, një nëpunës i AQ-së me përgatitje profesionale nga fusha e drejtësisë);
 - 1.4. Kryesuesi dhe zv.kryesuesi vijnë nga të emëruarit nga radhët e drejtorëve, ndërsa përfaqësuesi nga zyra ligjore kryen shërbimet e sekretarisë, administratës dhe shërbimet tjera juridike.
2. Zgjedhja e anëtarëve të KZAQ-së bëhet nga rektori.
3. Procesverbalet e KZAQ-së hartohen dhe nënshkruhen nga kryesuesi dhe anëtarët e KZAQ-së.
4. Mbledhjet e komisionit thirren nga kryesuesi i KZAQ-së. Mbledhjet mund të mbahen me prezencë fizike dhe përmes platformave online.
5. KZAQ-ja është përgjegjëse për të zbatuar dinamikën zgjedhore të miratuar nga KQZ UP, në nivel të veprimeve zgjedhore në Administratën Qendrore dhe në Bibliotekën Qendrore Universitare (BQU).
6. KZAQ-ja zgjidhet me rastin e shpalljes së zgjedhjeve të përgjithshme dhe ka mandat katër (4) vjeçar të funksionimit.

Neni 22

Data e zgjedhjeve të përgjithshme

1. Këshilli Drejtues e shpall datën e zgjedhjeve të përgjithshme në UP dhe në të njëjtën mbledhje zgjedh edhe anëtarët e KQZ UP-së, sipas dispozitave të kësaj rregulloreje. Zgjedhjet zhvillohen sipas dinamikës së përcaktuar nga KQZ-ja.
2. Në ditën e zgjedhjeve, vendvotimet duhet hapur nga ora 08:00 deri në ora 16:00.
3. Komisioni Qendror Zgjedhor, në bashkërendim me KZF-të dhe KZAQ-në, duhet të shpallin lokacionin e vendvotimeve.

Neni 23

Mënyra e votimit

1. Votuesit me të drejtë vote duhet që personalisht të hedhin votën në kutinë e votimit, në vendvotimet përkatëse.
2. Asnjë votues nuk ka të drejtë të votojë në më shumë se një vendvotim.
3. Vendvotimi duhet të jetë mjaftueshëm i madh, të sigurojë zhvillim të rregullt të votimit sipas kësaj rregulloreje, duke siguruar fshehtësi të votimit, shikim dhe kontroll të lirë të kutisë së votimit dhe qasje të papenguar për vëzhguesit.

Neni 24

Mbikëqyrja e procesit zgjedhor

1. Zgjedhjet duhet të mbahen nga komisionet zgjedhore të fakulteteve dhe Komisioni Zgjedhor i Administratës Qendrore, nën mbikëqyrjen e KQZ UP-së.
2. Zgjedhjet mund të monitorohen nga institucione, organizata dhe palë tjera të interesit, në pajtim me Statutin e UP-së dhe legjislacionin relevant në fuqi.

Neni 25

Procedurat e votimit dhe fletëvotimet

1. Gjatë gjithë kohës së votimit, së paku dy (2) anëtarë të KZF-së, respektivisht të KZAQ-së, duhet të jenë të pranishëm për të siguruar mbarëvajtje të rregullt të procedurave zgjedhore.
2. KZF dhe KZAQ duhet të ndërmarrin masa procedurale për mbarëvajtjen e zgjedhjeve, si në vijim:
 - 2.1. Krijimi i një ambienti të sigurt për votim dhe ruajtje të fshehtësisë së votimit;
 - 2.2. Hapja dhe mbyllja e vendvotimeve në kohën e caktuar dhe mbajtja e vendvotimeve hapur gjatë periudhës së caktuar të zgjedhjeve;
 - 2.3. Ofrimi i materialeve të nevojshme për votime;
 - 2.4. Shpërndarja e materialeve zgjedhore;
 - 2.5. Shënimi i procedurave të votimit në protokollin e komisionit zgjedhor;
 - 2.6. Vulosja e kutive të votimit;
 - 2.7. Shënimi i numrit të fletëvotimeve dhe numërimi i votave;
 - 2.8. Shënimi i rezultateve të zgjedhjeve.
3. KQZ UP do të mbikëqyrë zbatimin e kompetencave nga ana e KZF-së dhe KZAQ-së.

Neni 26

Rrjedha e procedurës zgjedhore dhe të votimit

1. Procedura zgjedhore zhvillohet sipas ecurisë si në vijim:
 - 1.1. Komisioni i zgjedhjeve kërkon nga votuesi të identifikohet me dokument të identifikimit (letërnjoftim, pasaportë, patentë shoferi);
 - 1.2. Komisioni i zgjedhjeve kërkon nga votuesi që të identifikohet me një nga

- kategoritë e personelit;
- 1.3. Komisioni i zgjedhjeve e gjen votuesin në listën e votuesve;
 - 1.4. Komisioni i zgjedhjeve kërkon nga votuesi të nënshkruhet në listën e votuesve;
 - 1.5. Komisioni i zgjedhjeve i jep votuesit fletëvotimet e duhura;
 - 1.6. Votuesi voton në kabinën e votimit;
 - 1.7. Komisioni zgjedhor zëvendëson një fletëvotim sipas kërkesës nëse votuesi e ka dëmtuar atë dhe për këtë mban shënim zyrtar;
 - 1.8. Votuesi e hedh fletëvotimin në kutinë e votimit;
 - 1.9. Votuesi del nga vendvotimi menjëherë pas votimit;
 - 1.10. Komisioni zgjedhor shënon në protokoll çdo cenim të këtyre procedurave.

Neni 27 **Fletëvotimi dhe vlefshmëria**

1. Secili fletëvotim duhet të përmbajë emrat e të gjithë kandidatëve, të cilët janë regjistruar për mandate të caktuara. Kandidatët radhiten në fletëvotim sipas alfabetit me emër dhe mbiemër.
2. Secili votues ka të drejtë të votojë në fletëvotim aq kandidatë sa edhe ka mandate në konkurrim në zgjedhjet e caktuara. Një përshkrim i përshtatshëm përkitazi me mënyrën e votimit duhet të jepet në fillim të fletëvotimit.
3. Fletëvotimet janë të vlefshme kur janë votuar maksimumi i kandidatëve të paracaktuar, ose më pak se maksimumi i përcaktuar.
4. Fletëvotimet nuk janë të vlefshme kur:
 - 4.1. Votohen më shumë kandidatë sesa maksimumi i përcaktuar, siç ceket në fletëvotim;
 - 4.2. Kur nuk votohet asnjë kandidat;
 - 4.3. Në raste të tjera të prishjes me qëllim të fletëvotimit, sipas standardeve dhe praktikave të aplikuara nga KQZ e Republikës së Kosovës.
5. Në rast të ankesave, KQZ UP-ja ka të drejtë të hapë kutitë e votimit, për të vërtetuar vlefshmërinë ose pavlefshmërinë e votës, në kuptim të këtij neni.

Neni 28 **Rezultatet e zgjedhjeve dhe hedhja e shortit**

1. KQZ UP është i obliguar të shpallë rezultatet zyrtare të zgjedhjeve brenda njëzet e katër (24) orëve pas mbylljes së vendvotimeve.
2. Në rastet kur dy (2) ose më shumë kandidatë kanë marrë numrin e njëjtë të votave, atëherë duhet të organizohet hedhja e shortit nga ana e KQZ UP-së, që do të vendosë për ndarjen përfundimtare të mandateve. Ky parim vlen për të gjitha rastet që kanë vota të barabarta në procesin e votimit, sipas kësaj rregulloreje, përveç në rastin e zgjedhjes së dekanit.
3. Shorti duhet të organizohet brenda dyzet (48) orëve pas shpalljes së rezultateve të zgjedhjeve në prani të kandidatëve. Mosprania e kandidatit, pas ftesës në mënyrë të

rregullt dhe të sigurt, nënkupton heqje dorë nga mandati.

Neni 29

Periudha e ankesave pas shpalljes së rezultateve

1. Pala e pakënaqur me rezultatin e shpallur të zgjedhjeve ka të drejtë ankese brenda dy (2) ditë pune.
2. Pas kalimit të periudhës kohore të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, të gjitha ankesat e dorëzuara me shkrim në lidhje me procedurat e zgjedhjeve, rezultatet e votimeve dhe mandatet e fituara do të refuzohen si të pasafatshme.
3. KQZ UP vendos për të gjitha ankesat brenda periudhës prej 2 ditëve të punës pas mbylljes së afatit për pranimin e ankesave.
4. Pas përfundimit të periudhës së përcaktuar në paragrafin 1 dhe 3 të këtij neni, Komisioni Qendror Zgjedhor duhet të shpallë rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve.

Neni 30

Ushtrimi dhe përfundimi i mandateve

1. Mandati i rektorit, dekanit, anëtarit/es të Senatit dhe anëtarëve të këshillit të fakultetit përfundon me arritjen e moshës së pensionimit, me rastin e dënimit me vendim të formës së prerë nga ana e gjykatës si dhe rasteve tjera të përcaktuara në këtë rregullore.
2. Në rast të përfundimit të parakohshëm të mandatit të dekanit, organizohen zgjedhjet e reja, sipas procedurës së përcaktuar në këtë rregullore. Nëse përfundimi i mandatit të dekanit, sipas kushteve të përcaktuara në Statut, ndodh gjashtë (6) muaj para përfundimit të mandatit të tij/saj, emërimi i UD detyrës së dekanit bëhet nga ana e rektorit.
3. Mandatet zëvendësohen sipas përcaktimit në këtë rregullore.
4. Procedura e zëvendësimit të mandateve verifikohet nga ana e KQZ UP-së.

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 31

Vlefshmëria dhe zbatimi

1. Në rast konflikti të ndonjë dispozite të kësaj rregulloreje me rregulloret tjera, të cilat rregullojnë procedurat zgjedhore për zgjedhjet e personelit akademik dhe jo akademik në organe të ndryshme në nivel të fakultetit (këshill të fakultetit apo dekan) dhe në nivel të universitetit (anëtar i Senatit apo rektor), vlejné dispozitat e Statutit dhe kësaj rregulloreje.
2. Për të gjitha çështjet lidhur me vendimet apo procedurat e kontestuara në lidhje me këtë rregullore, vendos KQZ UP.

3. KQZ-UP/KZF/KZAQ janë përgjegjës për zbatimin e kësaj rregulloreje.
4. Interpretimin autentik të kësaj rregulloreje e bën KQZ UP.

Neni 32 Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohet rregullorja me nr. prot. nr. 771, datë 9.3.2020, për rregullat dhe procedurat për zgjedhjet e përgjithshme të personelit akademik dhe jo akademik në nivel të përfaqësimit në UP, rregullorja me nr. prot. 748, datë 13.4.2022, si dhe të gjitha vendimet e mëhershme lidhur me objektin e kësaj rregulloreje.

Neni 33 Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Drejtues i Universitetit të Prishtinës.



Altin Sahiti

Kryesuesi i Këshillit Drejtues


SHTOJCA NR. 1 - FORMULARI PËR APLIKIM

Komisioni Qendror Zgjedhor

i zgjedhjeve të përgjithshme të UP-së, viti 2024

Formular aplikimi

për zgjedhjet e përgjithshme 2024



1. T'i dorëzohet Komisionit Zgjedhor të Fakultetit, jo më vonë se deri më __/__/__, në orën 15:30 (në zyrën e sekretarit të fakultetit ose përmes postës zyrtare elektronike).

2. T'i dorëzohet Komisionit Zgjedhor të Administratës Qendrore, jo më vonë se deri më __/__/__, në orën 15:30 (në zyrën e kryesuesit të KZAQ-së ose përmes postës zyrtare elektronike).

Regjistrohem si kandidat për (zgjidhni opsionin e duhur duke shënuar katrorin me "x"):

- Anëtar i këshillit të fakultetit nga radhët e profesorëve
- Anëtar i këshillit të fakultetit nga radhët e asistentëve
- Anëtar i Senatit nga personeli akademik
- Anëtar këshillit të fakultetit nga personeli joakademik
- Anëtar i Senatit nga personeli joakademik (nga fakulteti)
- Anëtar i Senatit nga personeli joakademik (nga AQ, BQU)

Fakulteti: _____

Emri dhe mbiemri: _____

Data e lindjes: _____

Titulli akademik²: _____

Pozita³: _____

Departamenti: _____

Data: _____


Nënshkrimi: _____

² Vetëm për personelin akademik;

³ Vetëm për personelin jo akademik (zyrtar për shërbime studentore, bibliotekar, laborant etj.).

SHTOJCA NR. 2 - FORMULARI PËR ANKESA

Komisioni Qendror Zgjedhor
i zgjedhjeve të përgjithshme të UP-së, viti 2024



FOMULARI I ANKESËS (t'i dërgohet Komisionit Qendror të Zgjedhjeve)

PARASHTRUESI I ANKESËS:

Emri dhe mbiemri: _____

Fakulteti/Departamenti: _____

KRYESI/T I/E SUPOZUAR I/TË SHKELJES:

Emri dhe mbiemri: _____

Fakulteti/Departamenti: _____

SHKELJA E SUPOZUAR

Të përshkruhet shkelja e supozuar në hollësi (vendi, data dhe koha kur ka ndodhur shkelja e supozuar). Nëse është e nevojshme, mund të bashkëngjiten fletë shtesë.

Data: _____

Nënshkrimi: _____

> Për çdo shkelje të supozuar kërkohet nga një formular i veçantë <